

Zyra e Burimeve Njerëzore

Në bazë të nenit 54, 63, dhe 65 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë, nr.35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15 dhe 30/16)dhe neni 37 i Statutit të Universitetit, Universiteti shpall kete :

THIRRJE

Për kandidim për Dekan të Fakultetit të Drejtësisë

Qëllimi primar i pozitës: Të udhëheq Fakultetin në çështjet akademike dhe hulumtuese dhe të sigurojë menaxhim efektiv të politikave të Fakultetit, proceseve dhe procedurave; dhe të përfaqësojë Fakultetin dhe Universitetin, duke siguruar dhe mbrojtur suksesin dhe reputacionin e tij.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligji, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet që vijojnë:

- Diplomë doktorature (PhD)
- Profesor Ordinar , Profesor Inordinar (I Asocuar) ose ekuivalent (Docent në qoftë se nuk ka rang më të lartë dhe/apo të përshtatshëm)
- Dëshmi për hulumtim të suksesshme dhe publikime në lëmin akademik relevant
- Njohuri të mira të lëmsisë - trendeve profesionale specifike të aktiviteteve në arsimin e lartë në shtet dhe në nivel ndërkombëtar në një lëmi relevante akademike

Preferohet:

- Eksperience në menaxhim dhe administrim efektiv të një departamenti / seksioni akademik
- Njohja e mirë e të gjitha kurikulave dhe fushave në fakultet
- Njohuri të mira të lëmsisë -trendeve profesionale specifike të aktiviteteve në arsimin e lartë brenda Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Procesit të Bolonjës

Kandidati duhet të posedojë shkathtësi dhe aftësi:

Themelore:

- Komunikim efektiv (gojor dhe të shkruar), së paku në dy nga tri gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit (shqip, maqedonisht dhe anglisht) dhe kontribut për implementimin e politikës gjuhësore; personel ndërkombëtar në gjuhën Angleze.
- Aftësi për të menaxhuar dhe motivuar stafin në mënyrë të suksesshme
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndërnjerëzore dhe komunikative (gojor dhe të shkruar)
- Aftësi për të analizuar dhe përdorur të dhëna komplekse në mënyrë efektive
- Pjesëmarrje të shkëlqyer dhe përpikshmëri dhe shfrytëzim efikas të orarit të punës
- Shkathtësi të shkëlqyera organizative
- Aftësi për punë fleksibile dhe të pavarur me vetmotivim, kreativitet dhe iniciativë
- Aftësi për të punuar nën presion, të zgjidh probleme dhe kryejë detyra brenda afateve kohore
- Aftësi për të përdorur Teknologjinë e Informatikës dhe sistemet kompjuterike të Universitetit
- Mundësi për të punuar, në mënyrë pozitive dhe përkrahëse me studentët
- Zotim dhe lojalitet ndaj Universitetit dhe misionit të tij, si prioritet më i lartë
- Aftësi dhe gatishmëri për të udhëtuar kur është e nevojshme

Afati i paraqitjes

Thirrja për shprehje të interesit hapet prej **29.02.2016** deri me **24.06.2016**

Aplikimet vetëm përmes e-mailit: : jobs@seeu.edu.mk

Adresa:

Universiteti i Evropës Juglindore
Zyra e Burimeve Njerëzore
Bul. "Ilindenit", 335,
1200 Tetovë, Maqedoni
Telefoni për kontakt: 044 356 087